



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:064774

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06100364

KF.nr.533/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe procesmbajtësen Arlinda Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit N.SH “Autoservis Volkswagen”, me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Urim Bajraktari, avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlera e kontestit 47,925.87 €, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat Urim Bajraktari dhe përfaqësueses së autorizuar të paditurës Krenare Shala, me datë 31.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.SH “Autoservis Volkswagen”, me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Urim Bajraktari, avokat në Ferizaj, si e pa bazuar.

II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/11361 i datës 23.12.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi N.SH “Autoservis Volkswagen”, me seli në Pejë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 07.04.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/11361 të datës 23.12.2020 të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes së parimit të ligjshmërisë, parimit të proporcionalitetit, parimit të objektivitetit dhe paanësisë, parimit të administratës së hapur si dhe parimit të informimit dhe ndihmës aktive. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka

deklaruar se: Mbesim në tërësi pranë padisë dhe parashtresave të dorëzuara në gjykatë duke shtuar që fakt kontestues gjatë vendosjes nga Shkalla e Dytë pranë Doganës ka qenë mënyra e dorëzimit të vendimit tek personi juridik e që sipas padisë në këtë mënyrë e kemi kontestuar për faktin që në nenin 104 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i cili përshtatmërisht aplikohet edhe te procedura administrative në raport me dorëzimin e shkresave të palëve në procedurë, e që organi i shkallës së dytë i Doganës ka vendosur që ta hedhë ankesën e palës në procedurë si të pasafatshme për kundër faktit që në vet arsyetimin e këtij vendimi thekson që pas komunikimit me postën e Kosovën, postieri i cili ka qenë prezent në momentin e dorëzimit të vendimit ka qenë që më sa e kujtoj ka qenë djali i pronarit i cili e ka pranuar vendimin, që për ne kjo mënyrë apo formë e dorëzimit të vendimit është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të cilat i cituam më lartë, andaj nga ky shkak vendimi i atakuar është i paligjshëm. Dogana konkretisht Shkalla e Dytë duke vepruar si në vendimin e atakuar ka shkelur dispozitat ligjore duke mos vendosur në mënyrë meritore ose duke e hedhur ankesën si të pasafatshme, ne vlerësojmë që si në padi ashtu edhe nga parashtresat lidhur me precizimet kemi edhe shkaqet e mjaftueshme sepse vendimi i atakuar nuk është nxjerrë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore aq sa palës i është pamundësuar që ti trajtohet lënda sipas ligjit. Andaj, i propozojmë gjykatës që të anulohet vendimin e Shkallës së Dytë konkretisht vendimi nr.01.3.2.2/11361 ose lënda të kthehet rishqyrtim-rivendosje për shkak të kundërligjshmërisë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padinë të datës 27.10.2021 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës ka deklaruar se: E kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, Dogana pas pranimin të ankesës së paditësit apo subjektit dhe pas shqyrtimit të pretendimeve, dokumenteve, provave për rishqyrtim të vendimit në fjalë ka konstatuar se kërkesa-ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor. Sa i përket pretendimeve të paditësit se aktvendimin e Doganës-SPK të datës 22.10.2020 nuk e din se kush e ka pranuar Dogana ka kërkuar nga posta e Pejës që të na informoj se kush e ka pranuar aktvendimin në fjalë pasi që në fletë-kthesë ka qenë vetëm nënshkrim. Me datën 11.11.2020 nga posta e Pejës është kthyer përgjigja duke bashkangjitur librin e dorëzimit si dëshmi i dorëzimit të shkresës në fjalë dhe është cekur se me sa i kujtohet shkresa i është dorëzuar djalit të pronarit-biznesit në fjalë.

SKP me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike se kush e ka pranuar vendimin në fjalë ka kërkuar nga avokati i paditësit që të sjellë kopjet e pasaportës së pronarit dhe djalit të tij, kopje këto të cilat nuk i ka sjellë. Në bazë të provave, dokumenteve që i ka poseduar nënshkrimi korrospodon me atë të djalit të pronarit, andaj edhe sipas Doganës konsiderohet komunikimi i rregullt. Aktvendimi i atakuar është marrë komform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo për të cilën pretendon pala që ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë komform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me asnjë provë të vetme relevante juridike. Andaj, propozojmë gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 31.07.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi nr.11361/23.12.2020, Kërkesa e ushtuar në Doganë e datës 27.12.2018, Ankesa e ushtuar në Doganë, Aktvendimi 2020-24/1 i datës 07.02.2020, Përgjigja në padi, Letër kthesa e Doganës e datës 25.02.2020, Libri i dorëzimit nga Posta i datës 24.02.2020, Kërkesa për vlerësim të veturave e datës 29.01.2020 dhe Të dhënat nga ARBK për subjektin këtu paditësin.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura me datë 07.02.2020, ka nxjerr aktvendimin nr. 03.1.1-2020-24/1, me të cilin e ka obliguar subjektin e lartcekur që në afat prej 10 ditësh të paguaj obligimin doganor, dhe atë taksa doganore 2,499.15 €, akciza 34,300.00 € dhe TVSH-në 11,126.72 €, gjithsejtë 47,925.87 €, për shkak të 18 automjeteve të pa zhdoganuara për shitjen e pjesëve të tyre. Jo kontestuese mbetet edhe fakti se subjekti në procedurë kundër aktvendimit të lartcekur me datën 15.09.2020 (datë e dorëzimit në postë), ka ushtuar ankesë, e

për të cilën ankesë, e paditura me datë 23.12.2020 ka sjell Aktvendimin nr.01.3.2.2/11361, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit akt paditësi me padinë e datës 07.04.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së lartcekur, e ka hedhur poshtë kërkesën e subjektit në procedurë N.SH “Autoservis Volkswagen”, me seli në Pejë, për rishqyrtimin aktvendimit 03.1.1-2020-24/1 të datës 07.02.2020 të lëshuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, si të ushtruar jashtë afatit ligjor, me arsyetim se aktvendimi i lartcekur siç konfirmohet nga fletë kthesa e postës është pranuar me datën 24.02.2020 ndërsa ankesa është ushtruar me datën 15.09.2020 (datë e dorëzimit në postë), andaj, meqenëse subjekti konform nenit 291 par.2 të KDA-së ka pasur të drejtë e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimeve të lartcekura brenda afatit prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit të vendimit, ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor. Prandaj, nga kjo gjendje faktike gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e aktvendimit të kontestuar të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me aktvendimin kontestues, dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se e paditura në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 104 lidhur me nenin 110 të LPK-së, të cilat në mënyrë analoge aplikohen edhe në procedurën administrative, kjo për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës, e paditura Dogana e Kosovës ka vepruar drejtë kur e ka hedhur poshtë kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit si të ushtruar jashtë afatit ligjor, sepse nga shkresat e lëndës në mënyrë të qartë vërtetohet se aktvendimi 03.1.1-2020-24/1 i datës 07.02.2020, ka përmbajtur këshillën juridike ku pala e pakënaqur me këtë aktvendim është udhëzuar që të ushtroj kërkesë

për rishqyrtim tek Sektori për Rishqyrtime të Vendimeve pranë Doganës së Kosovës në afat prej 30 ditësh konform nenit 291 par.2 të KDA-së, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Ndërsa nga fletë kthesa e postës vërtetohet se subjekti në procedurë aktvendimin e lartcekur e ka pranuar me datën 24.02.2020, kurse ankesën e ka ushtruar me datën 15.09.2020 (datë e dorëzimit në postë), që do të thotë se subjekti në procedurë nuk i është përmbajtur afatit të lartcekur, ngase siç u theksua më lartë me dispozitën ligjore nga neni 291 par.2 përcaktohet se *“Kërkesa për rishqyrtim të vendimit ushtrohet pranë Doganës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit”*. Gjykata e ka vlerësuar si të pa bazuar pretendimin e paditësit se në rastin konkret është vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 104 të LPK-së, kjo për faktin se me këtë dispozitë në mënyrë të qartë përcaktohet se *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke i'u dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalit e punës”*.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar - administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se dërgimi i aktvendimit të lartcekur është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të lartcekura. Prandaj, si rezultat Gjykata konsideron se paditësi në këtë kontest tregtar-administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se aktvendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë kontest tregtar - administrativ, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë*

*prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*". Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike gjykata vlerëson se aktvendimi nr.01.3.2.2/11361 i datës 23.12.2020 i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e subjektit në procedurë si e ushtruar jashtë afatit ligjor, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.533/22 datë 31.07.2024

Procesmbajtëse

Arlinda HYSENI

\_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

\_\_\_\_\_

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate